



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 818/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje prej një panelisti individual nga Agon Ramadani duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Company Murseli SHPK" me seli ne Kaçanik, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Përzgjedhja e kompanisë për kryerjen e shërbimeve të demolimit dhe rrënimin e objekteve pa leje ndërtimi, ri-tenderim" me numër te prokurimit nr. 613-22-13078-2-2-1, parashtruar ndaj Autoritetit Kontraktues Komuna e Lipjanit, me datën 07. 02. 2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, pajtimi i palëve për ankesën e OE "Company Murseli SHPK" me seli ne Kaçanik, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30. 12. 2022 (me numër protokolli 818/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Përzgjedhja e kompanisë për kryerjen e shërbimeve të demolimit dhe rrënimin e objekteve pa leje ndërtimi, ri-tenderim" me numër te prokurimit nr. 613-22-13078-2-2-1, parashtruar ndaj Autoritetit Kontraktues Komuna e Lipjanit.

II. Obligohet, Autoriteti Kontraktues që për aktivitetin e sipërcituar, të veprojë konform raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK dhe OE ankues janë pajtuar.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se OE ankues është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues për këtë aktivitet të prokurimit dhe sipas raportit të ekspertit ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.11.2022, AK Universiteti i Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin për Kontratë (dosja e tenderit) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Përzgjedhja e kompanisë për kryerjen e shërbimeve të demolimit dhe rrënimin e objekteve pa leje ndërtimi, ri-tenderim" me numër të prokurimit nr. 613-22-13078-2-2-1.

AK me datën 14. 12. 2022 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës OE "NTSH Durimi & Dardania", duke i dërguar OE ankues letrën standarte për tenderuesin e eliminuar.

Kërkesa për ri shqyrtim me datën 20.12.2022. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës me datën 21.12.2022.

Me datën 30.11.2022 Operatori ekonomik, "Murseli shpk", ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 818/2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të përshkruar si më sipër.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta

bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 20. 01. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- të anulohet, aktiviteti i prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Duke u bazuar në faktet, provat dhe sqarimet e lartpërmendura si dhe duke i shqyrtuar, krahasuar dhe analizuar të gjitha faktet dhe provat e prezantuara nga AK dhe OE ankues, mendimi ynë është se Autoriteti Kontraktues gjatë procesit të aktiviteteve të Tenderit ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 8.4 të nenit 108/A; nenin 72 të LPP si dhe paragrafët 38.3;38.4 dhe 38.5 të nenit 38 të Rregullores nr. 001/2022, dt. 20.10.2022, për Prokurimin Publik, sepse ka rekomanduar për Kontrate OE pa vlerësimin e Dokumenteve të Tenderit sipas dispozitave të më lartë cekura respektivisht legjislacionit në fuqi. Në vendimin për refuzimin e Kërkesës për ri-vlerësim shton arsye të re të eliminimit të ankuesit mos prezantimin e listës së projekteve të realizuara , dhe potencon se nuk kanë prezantuar dëshmi lidhur me realizimin e projekteve të ngjashme të realizuara e që si arsye për eliminim nuk është dhënë në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar. Arsyen për eliminimin e ankuesit AK e mbështet të i vetmi argument se OE ankues ka ofruar dëshmi për Kamionet e jo Kamion siç kërkohet në DT. Por OE ankues prezanton si dëshmi për marrjen me qira të Kamionit me korpë, Kontratën e lidhur me Qiradhënësin "Elektra" LL.C, nr.01-12/2022.

Duke u bazuar në sqarimet e më lartë përmendura Eksperti Shqyrtues mendon që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues,"Company Murseli SHPK" me seli në Kaçanik, është e bazuar prandaj i propozon Panelit Shqyrtues që ta pranoi ankesën dhe Lëndën ta kthejë në Ri-vlerësim.

Eksperti shqyrtues në bazë të nenit 114 paragrafi 2 të LPP-së, rekomandon Autoriteti Kontraktues – Te anuloi njoftimin – propozimin për dhënie të kontratës dhe Aktivitetin e Prokurimit ta kthejë në ri vlerësim duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 20 janar 2023 me raportin e ekspertizës.

1. Autoriteti kontraktues – Komuna e Lipjanit, me datën 24 janar 2023 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së .
2. Operatori ekonomik ankues "Murseli SHPK", me datën 24 janar 2023 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit, paneli shqyrtues deklaroi

se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit, që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së Komuna e Lipjanit
- 1x1 OE "Murseli shpk"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.